



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel/fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n
E-mail: Info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	20.01.2026
NR/BR.	17/2026
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me Nr:01.Nr.10 i datës 30.12.2025

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 nenit 52. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 4,5 dhe 6 i udhëzimit administrative (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë neni 17, paragrafi 17.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Ferizajt përmes Kuvendit bënë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me Nr: 01.Nr.10 i datës 30.12.2025

ARSYETIMI

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2025, ka miratuar Vendimin 01.Nr.10 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Ferizajt.

Vendimi 01.Nr.10 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Ferizajt, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore si dhe me Udhëzimin administrativ (MAP) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Në nenin 6, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit Nr:05/L-020 për Barazi Gjinore, parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.

Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislarive, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesdhjetë përqind (50%) për secilin gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese edhe vendimmarrëse".

Ndërsa neni 5 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, përcakton se komitet duhet të reflektojë barazin gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi"

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Ferizajt duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfardo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.